



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 546/005  
Dt 06.04.2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.3.2018, mori:

**VENDIM**

- I. Ass. Fatbardha Hoxhës, u. d. dekane në Fakultetin e Edukimit, i aprovohet kërkesa për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për organizimin e Konferencës ndërkombëtare me temë "Trauma and Family: strengthening community support systems", që do të mbahet në objektet e kampusit të ri universitar, më 15-16 maj 2018.
- II. Shuma e mjeteve të lejuara për këtë destinim është në lartësi deri në 4 000 €.
- III. Zyra për buxhet dhe financa e UMIB-it është i obliguar të bëjë ekzekutimin e këtij vendimi në bazë të faturave përkatëse.
- IV. Zyra e TI-së së UMIB-it është e obliguar të sigurojë pajisjet e nevojshme teknologjike për organizim sa më të suksesshëm të kësaj konference

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues pasi shqyrtoi kërkesën e ass. Fatbardha Hoxhës, u. d. dekane në Fakultetin e Edukimit, për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për organizimin e Konferencës ndërkombëtare me temë "Trauma and Family: strengthening community support systems", që do të mbahet në objektet e kampusit të ri universitar, më 15-16 maj 2018, e konsideroi të arsyeshme kërkesën për shkak se kjo konferencë ofron mundësi unike për promovimin e vlerave të institucionit, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivel ndërkombëtar, pasi është konferencë që organizohet në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, Ministrinë e Shëndetësisë, MASHT-in dhe Shoqatën kosovare për Terapi familjare, si dhe ndikon pozitivisht në punën kërkimore-shkencore brenda institucionit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurës;
3. Zyrës për buxhet dhe financa
4. Zyrës së TI-së



Kryesuesi Këshillit Drejtues

Dr. sc. Sabri Sadiku